

---

# AKT THEMELIMI

## "INTERNATIONAL REAL INVESTMENT" SHPK

### 1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë "INTERNATIONAL REAL INVESTMENT" SHPK, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

### 2. Ortaku i vetëm i shoqërisë është:

- "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK me nr. NUIS M21612025K me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.

### 3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- **Aktivitet në fushën e pasurive të paluajtshme të çdo lloji, duke përfshirë toka, troje, ndërtesa banimi dhe shërbimi, blerje, shitje, ndërmjetësim, dhënie dhe marrje me qira të këtyre pasurive të paluajtshme brenda dhe jashtë vendit. Investime në pasuri të paluajtshme duke përfshirë projektimin, financimin, ndërtimin, menaxhimin dhe çdo veprimtari tjetër të lidhur me sa më sipër, pa asnjë përjashtim. Veprimtari në fushën e turizmit dhe zhvillimit infrastrukturor.**

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

### 4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.



---

## 5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## 6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 100,000 (njëqind mijë lekë).
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale ALL 100,000 (njëqind mijë lekë) dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

## 7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

## 8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është: **Znj. Jurgena SHEHU, shtetase Shqiptare, e datëlindjes 29.07.1999, banuese në Tiranë, e identifikuar nga pasaporta me nr. BI4913871 dhe nr. personal J95729033J.**


## 9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

### ORTAKU I VETËM

### SHOQËRIA "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK

Përfaqësuar nga Zj. Eda Spahiu



[emër, mbiemër, firmë, vulë] - **26.09.2022**